

Një Vështrim mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Mars 2020

Kjo është një përmbledhje e indikatorëve kryesorë të situatës ekonomike në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare ose organizata ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.



Përmbajtja


- Llogaritë Kombëtare
- Tregtia e Jashtme
- Tregu i Punës
- Investimet
- Tregues Monetar
- Renditja e Shqipërisë sipas:
 - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
 - Indeksi i Lirisë ekonomike
 - Lehtësia e të Bërit biznes
 - Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore
 - Indeksi Global i Inovacionit




Ecuria e Treguesve Kryesore Makroekonomikë në 2020

- ❖ *PBB ra gjatë vitit 2020 me 3,3% krahasuar me vitin 2019, pas pandemisë COVID19*
- ❖ *Inflacioni mbeti nën objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3% dhe rregjistroi 1,6%, 0.2 p.p më shumë se viti 2019*
- ❖ *Flukset e IHD-ve ranë me 13,1% krahasuar me vitin 2019, ndërsa stoku i IHD-ve u rrit me 8,2%. Hollanda vazhdon të jetë lider në flukset hyrëse të IHD-ve për dy vjet me radhë, megjithëse me një ritëm në rënie. Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicionim vazhdon të jetë aktiviteti më tërheqës për IHD-të.*
- ❖ *Shkalla e papunësisë u rrit gjatë vitit 2020, me 0,2 p.p krahasuar me 2019*

Ecuria e Rritjes Ekonomike



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë e nisur nga viti 2015, u ngadalësua përgjatë vitit 2019 dhe ra përgjatë vitit 2020 me -3,3%, si rezultat i pandemisë COVID19




Përballimi i dy emergjencave civile të njëpasnjëshme, Tërmeti i Nëntor 2019 dhe pandemia COVID-19, kanë ulur ndjeshëm parashikimet e rritjes ekonomike të Shqipërisë, dhe jo vetëm, për **vitin 2020**.



Ecuria e Rritjes Ekonomike

Rritja ekonomike e Shqipërisë




Bazuar në të dhënat paraprake, Produkti i Brendshëm Bruto në Shqipëri ra me 3.3%, më pak se parashikimet e mëparshme.

PBB arriti në 1607.9 miliardë lekë nga 1679.2 në vitin 2019.



Rritja Ekonomike Sipas Sektorëve




Bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT, Prodhimi i Brendshëm Bruto në TI të vitit 2020 si rezultat i COVID-19, u ul me 2.52%, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019. Rënia vazhdoi dhe arriti në -10.61% në QII të vitit 2020 , Vetëm në QIV 2020 PBB rregjistroi një rritje pozitive prej 2.99%.

Gjatë QIV, kontribut pozitiv në rritje erdhi nga të gjithë sektorët, me përjashtim të Bujqësisë, Pyjet dhe Peshkimit (-0.49 p.p) dhe Tregtisë, Transportit, Akomodimit dhe Shërbimit të Ushqimit (-0.96 p.p).

Kontributi në GDP sipas Sektorëve

Kontributi në PBB sipas sektorëve





Bujqësia, pyjet dhe peshkimi vazhdojnë të ketë kontributin më të madh në PBB, me 18% në 2019 dhe 20% gjatë vitit 2020.


Kontributi më i ulët në PBB vjen nga Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve me vetëm 2%.

E Ardhura për Frymë

Për vitin 2019, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet **5,353 USD** në vlerë korrente, në të njëjtat nivele të një viti më parë



Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme




Gjatë vitit 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën **272 mld lekë**, duke u ulur me **9 %**, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën **605 mld lekë**, duke u ulur me **7 %**, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën **146 mld lekë**, duke u ulur me **12 %**, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Eksportet e Mallrave

Eksporte sipas produkteve




Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre edhe gjatë vitit 2020, ku pjesa më e madhe janë Tekstile dhe Këpucë të ndjekur nga Minerale lëndë djegëse, energji elektrike dhe Ushqime pije dhe duhan.





Importet e Mallrave

Struktura e importeve të mallrave vazhdon të dominohet nga importet e Makineri, pajisje, Ushqimeve, pije, duhan dhe Makineri, dhe Produkte kimike dhe plastike.




Eksportet në Shërbime Konteksti Rajonal



Edhe gjatë vitit 2019, Shqipëria vazhdon të renditet e dyta në rajon përsa u përket eksportit të shërbimeve, ku dominojnë Udhëtimet me 62.3% të totalit të eksporteve. Serbia është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor përsa i përket eksportit të shërbimeve

Indeksi i Çmimit të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Përgjatë vitit 2020, inflacioni mesatar me bazë vjetore regjistroi vlerën 1.6%, më i lartë se një vit më parë, ku Inflacioni regjistroi vlerën 1.4%.

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%.

Forca e Punës


Norma e papunësisë



Gjatë vitit 2020 Shkalla e papunësisë u rrit me **0.2 p.p** krahasuar me një vit më parë.

Referuar të dhënave të INSTAT në Q4 / 2020, numri i të punësuarve u ul me 9.508 persona. Vihet re një rritje e punësimit në sektorin publik me 8.159 persona krahasuar me 2019 / Q4; ndërsa punësimi në sektorin privat (me përjashtim të bujqësisë ku ka një rënie prej 13.034 personash) u ul me 4.633 persona.

Paga Mesatare sipas Sektorëve (në Lekë)



Pagat më të larta janë regjistruar në sektorin e “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”.

Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”.


Rënia më e madhe në paga është vërejtur në Bujqësi dhe Aktiviteteve financiare; ndërsa rritja më e madhe në Administratën publike sektorin e pasurive të paluajtshme

Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer

Paga Mesatare dhe Paga Minimale

Paga mesatare mujore për një të punësuar dhe paga minimale e miratuar

- Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin shtetëror
- Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin privat
- Paga minimale e miratuar




Paga mesatare gjatë 2020 është raportuar në **56.475 lekë** me rritje **2,1%** kundrejt një viti më parë.

Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte **48.620 lekë** me një rritje **2,3%** krahasuar me një vit më parë ; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte **64.330 lekë**, me një rritje **2%** krahasuar me një vit më parë.

Paga minimale ngelet e pandryshuar në **26.000 lekë**.



Kosto e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor

Pagat mesatare për një të punësuar në Ballkanin Perëndimor (EURO)





Paga mesatare bruto më e lartë në rajon është regjistruar në Malin e Zi, e ndjekur nga Bosnjë dhe Hercegovina, ndërkohë Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon.

Investimet në Shqipëri





Pjesa më e madhe e investimeve në ekonomi vjen nga sektori i brendshëm. Gjatë vitit 2020, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks arriti në **23.25%** e Produktit të Brendshëm Bruto, ndërsa ato publike ishin në nivelin e **5,4%** të PBB

Investimet sipas Sektorëve



Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2019, investimet private u rritën me **1,5%**, dhe **62,1%** e Investimeve vinë nga prodhuesit e të mirave. Shumica e Investimeve gjatë vitit 2019, kanë qenë investime në Makineri dhe Pajisje, **27%** e totalit, duke ruajtur të njëjtin trend të vitit të mëparshëm edhe pse më një rënie prej **6p.p**

Investimet e Huaja Direkte




Gjatë vitit 2020, fluksi hyrës i IHD ka rënë me **13%** krahasuar me një vit më parë. Edhe pse flukset hyrëse të IHD kanë qënë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku i IHD në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës deri në TIV 2019. Gjatë vitit 2020, stoku i IHD u rrit me **8%** krahasuar me një vit më parë.



Investimet e Huaja Direkte

Stoku IHD sipas vendit të origjinës, milion EURO




Zvicra vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve në terma vëllimi, edhe gjatë vitit 2020, me **19%** të totalit, e ndjekur nga Holanda dhe me 16% të totalit.

Dinamika pozitive të IHD-ve vinë nga Austria, Turqia dhe Greqia.



Investimet e Huaja Direkte

Fluksi IHD sipas vendit të originës, milion EURO




Bazuar në të dhënat më të fundit të BSH, janë rritur flukset hyrëse të IHD nga Hollanda, Turqia dhe Bullgaria. Hollanda është vendi me flukset hyrëse më të larta për të dytin vit radhazi edhe pse me një rënie prej 54 mln Euro.

Ndërkohë edhe flukset hyrëse nga Zvicra edhe pse pozitive janë në rënie, e ndjekur edhe nga Austria dhe Greqia.


Investimet e Huaja Direkte

Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, milion EURO



Sektorët më tërheqës për IHD-të ngelen Energjia elektrike, Minierat dhe Industritë Nxjerrëse, dhe, edhe pse kjo e fundit në rënie duke filluar nga viti 2019.

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor




Shqipëria renditet e dyta në rajon për IHD me 7,9% të PBB.

Serbia udhëheq rajonin për sa i përket flukseve hyrëse të IHD të cilat janë sa 8,3% e PBB.

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor, milion USD



Flukset hyrëse të IHD në Serbi arritën në **4 miliardë USD** për vitin 2019, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e **1,2 miliardë USD**.

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD në rajon është Kosova me **285 milionë USD**.


Stoku Dhe Profili i Ndërmarrjeve

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar


Sipas numrit të të punësuarve	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjithsej	106,837	111,083	112,537	152,288	160,679	162,452	162,835	162,342
1-4	95,520	99,782	101,025	136,470	145,456	146,304	145,549	144,857
5-9	5,636	5,235	5,387	8,172	7,631	8,023	8,518	8,569
10-49	4,439	4,660	4,647	5,994	5,902	6,297	6,801	6,932
50+	1,242	1,406	1,478	1,652	1,690	1,828	1,967	1,984
Prodhuesit e të mirave	16,413	16,842	16,989	37,950	48,585	53,250	56,916	60,061
1-4	12,592	13,071	13,273	33,255	44,179	48,819	52,269	55,342
5-9	1,718	1,565	1,603	2,080	1,865	1,842	1,858	1,871
10-49	1,650	1,681	1,562	1,971	1,877	1,851	1,987	2,052
50+	453	525	551	644	664	738	802	796
Prodhuesit e shërbimeve	90,424	94,241	95,548	114,338	112,094	109,202	105,919	102,281
1-4	82,928	86,711	87,752	103,215	101,277	97,485	93,280	89,515
5-9	3,918	3,670	3,784	6,092	5,766	6,181	6,660	6,698
10-49	2,789	2,979	3,085	4,023	4,025	4,446	4,814	4,880
50+	789	881	927	1,008	1,026	1,090	1,165	1,188

Ndërmarrjet Aktive Sipas Aktivitetit Ekonomik


Ndërmarrjet aktive, fundviti 2019




Ndërmarrje aktive, 2019





Ndërmarrje të reja, fundviti 2019



Kompani të reja, 2019



Kredia për ekonominë




Kredia totale për ekonominë arriti në 608.7 miliardë lekë në dhjetor 2020; ndërsa shumica e kredisë së re gjatë vitit 2020 shkoi në tregtinë me shumicë dhe pakicë me 42% të totalit.

Renditja e Shqipërisë në Raportet dhe Indekset Ndërkombëtare

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Transparency International							
Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
36,0	104/180	35,0	106/180	36,0	99/180	38,0	91/180
Indeksi i Lirisë Ekonomike, heritage.org							
Vlera 2021	Renditja 2021	Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018
65,2	66/180	66,9	57/180	66,5	52/180	64,5	65/180
Të bërit biznes, Banka Botërore							
		Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018
		67,7	82/190	69,5	63/190	68,7	65/190
Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore, Forumi Ekonomik Botëror							
		Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
		57,6	81/141	58,0	76/140		75/137
Indeksi Global për Inovacionin							
Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
27,23	83/131	42,42	70/129	29,98	83/126	28,86	115/127

Treguesi i Lehtësisë Së Të Bërit Biznes


Renditja e vendeve të Ballkanit Perëndimor, Lehtësia e të bërit biznes



Maqedonia e Veriut ka renditjen më të mirë në rajon edhe pse pozitat e saj janë përkeqësuar gjatë vlerësimit të 2020;

edhe Shqipëria ka përkeqësuar pozitat e saj gjatë vlerësimit 2020, krahasuar me një vit më parë.

Indikatorët e Të Bërit Biznes



Shqipëria renditet më poshtë në fushën e trajtimit të lejeve të ndërtimit, energjisë, procedurave fiskale dhe regjistrimit të pronës.

Tregtia Përtej Kufijve – DB 2020

Tregtia përtej kufijve - Eksporte, koha dhe kosto


	Shqipëria	Europa dhe Azia Qendrore	Renditja në 190 vende
Koha - Kontroll në kufi (orë)	9	22.1	
Kosto - Kontrolli në kufi (USD)	55	157.5	
Koha - Përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (orë)	6	24.3	
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (USD)	10	97.9	
Renditja			24

Tregtia Përtej Kufijve – DB 2020

Tregtia përtej kufijve - Importe

	Shqipëria	Europa dhe Azia Qendrore	Renditja në 190 vende
Koha - Kontroll në kufi (orë)	10	21.1	
Kosto - Kontrolli në kufi (USD)	77	162.3	
Koha - Përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (orë)	8	24.7	
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (USD)	10	93.9	
Renditja			24

Indikatorët e Konkurrueshmërisë




Gjatë 2019, indikatorët Infrastruktura, dhe Sistemi Financiar janë përmirësuar; ndërsa indikatorët Institucionet, Sofistikimet e biznesit dhe Inovacioni janë përkeqësuar.



Liria Ekonomike

Trendi i Lirisë Ekonomike, Shqipëria




Shqipëria renditet e 57a në rang botëror, duke humbur pesë pozicione nga viti i kaluar; Në rang rajonal, Shqipëria renditet e 30a nga 44 vende europiane.


Vendi qëndron poshtë mesatares europiane (69.8) por është mbi mesataren botërore (61.6).

Treguesit e Lirisë Ekonomike


Treguesit e Lirisë Ekonomike
Sundimi i Ligjit




Madhësia e qeverisë



Efektiviteti rregullator



Liria e të bërit tregti



Indeksi Global i Inovacionit

	2015	2016	2017	2018	2019	2020
SRB	70	65	58	56	57	53
MNE	40	46	52	55	45	49
ALB	112	71	115	83	70	83
MKD	55	62	63	84	59	57
BIH	122	104	86	68	71	74

Shqipëria renditet e 83-ta në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2021, e fundit në rajon; Mali i Zi kryeson rajonin në Inovacion sipas raportit të fundit të GII.

Rreth Këshillit të Investimeve në Shqipëri

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



REPUBLIKA E SHQIPËS
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).